

UDHËZIM
Nr. 4, datë 21.5.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E TERMAVE DHE KUSHTEVE PËR KATEGORIZIMIN E
VLERAVE KULTURORE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 53, dhe shkronjës “a” të nenit 268, të ligjit nr. 27, datë 17.5.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i termave dhe i kushteve për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshme, në kuptim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar.

2. Për qëllim të këtij udhëzimi “Vlerë kulturore” është dëshmia materiale e jomateriale e pranisë dhe e veprimtarisë njerëzore, fenomene apo peizazhe, të cilat janë të rëndësishme për individin, komunitetin apo shoqërinë si një e tërë dhe kanë vlerë shkencore apo kulturore; dëshmia materiale ose jomateriale e pranisë dhe veprimtarisë njerëzore, e cila është domethënëse për institucionet fetare të regjistruara; fragmente të objekteve arkeologjike, etnografike apo objekteve të tjera, që janë të fragmentarizuara, të cilat përbëjnë një pjesë të vogël të autenticitetit të objektit origjinal, që janë dëmtuar në masë të madhe, pa ndonjë vlerë të rëndësishme kulturore, shkencore ose artistike, dhe pjesa më e madhe e tyre mund të përkufizohet si materiale, kur janë pjesë e fondeve muzeore.

II. TERMAT PËR KATEGORIZIMIN E VLERAVE KULTURORE TË PALUAJTSHME

1. Termat e përcaktuar në këtë kre përdoren për kategorizimin e vlerave kulturore të pasurive të paluajtshme dhe shërbejnë për të përcaktuar rëndësinë e tyre në aspektet historike, artistike, shkencore, teknologjike, urbanistike, peizazhore dhe shoqërore. Këto vlera, veçmas ose të ndërthurura, shprehin kuptimin dhe rëndësinë e pasurisë për trashëgiminë kulturore dhe për identitetin historik e kulturor të vendit.

2. Vlerat klasifikohen, si më poshtë:

a) “Vlerë historike” pasqyron lidhjen e pasurisë me ngjarje, procese, personalitete, periudha ose zhvillime që kanë rëndësi për historinë kombëtare, rajonale apo lokale, si dhe për dëshminë e evolucionit të qytetërimit dhe të jetës shoqërore, kur pasuria:

i. lidhet me ngjarje, personalitete ose periudha historike me ndikim në zhvillimin e një komuniteti, rajoni apo të vendit në tërësi;

ii. përfaqëson dëshmi materiale të mënyrës së jetesës, teknologjisë ose organizimit shoqëror të një periudhe të caktuar;

iii. është e lidhur me zhvillimin e fushave të arkeologjisë, arkitekturës, peizazhit kulturor, trashëgimisë industriale ose bujqësore;

iv. përmban vlera dokumentuese që kontribuojnë në kuptimin e historisë lokale ose kombëtare.

b) “Vlerë artistike” përfshin cilësitë estetike, përbërjen formale, stilin arkitektonik, zbukurimin, mjeshtërinë e realizimit dhe shprehjen krijuese që e dallon pasurinë për veçantinë e saj, kur pasuria:

i. përfaqëson një nivel të lartë krijimtarie artistike ose mjeshtërie ndërtimore;

ii. shfaq tipare stilistike karakteristike për një periudhë, shkollë ose autor të veçantë;

iii. përbën shembull përfaqësues të estetikës tradicionale, arkitekturës popullore ose artizanatit lokal;

iv. kontribuon në zhvillimin e koncepteve artistike ose arkitektonike në nivel kombëtar apo rajonal.

c) “Vlera shkencore dhe teknologjike” përfaqëson rëndësinë e pasurisë për kërkimin, studimin dhe kuptimin e zhvillimeve në fushat e historisë, arkeologjisë, arkitekturës, teknologjisë, inxhinierisë dhe disiplinave të tjera shkencore, kur pasuria:

i. përmban të dhëna me rëndësi për studime historike, arkeologjike, arkitektonike ose teknike;

ii. ka potencial të lartë për kërkime shkencore ose për ruajtjen dhe transmetimin e njohurive tradicionale;

iii. dëshmon zhvillimin e njohurive dhe praktikave teknologjike ose ndërtimore, tradicionale apo inovative;

iv. ruan materiale, teknika ose metoda ndërtimi origjinale e përfaqësuese për periudhën e krijimit të saj.

d) “Vlerë urbane dhe e peizazhit”, lidhet me marrëdhënien e pasurisë me mjedisin përreth, integrimin në strukturën urbane, harmoninë vizuale dhe historike me peizazhin kulturor ose natyror ku ndodhet, kur pasuria:

i. është pjesë përbërëse e një ansambli ose strukture historike urbane me vlera të njohura;

ii. ndikon në formimin e identitetit vizual të peizazhit kulturor ose natyror;

iii. përmban elemente që sigurojnë lidhje të lexueshme ndërmjet trashëgimisë dhe mjedisit përreth;

iv. kontribuon në ruajtjen e karakterit të vendbanimeve tradicionale ose të ansambleve historike.

e) “Vlerë shoqërore” pasqyron domethënien që pasuria ka për komunitetin si simbol identitar, si vend kujtese kolektive, si qendër fetare, rituale ose shpirtërore, apo si pjesë e traditave dhe praktikave të trashëguara, kur pasuria:

i. është e lidhur me tradita, rite, besime ose kujtesë historike të komunitetit;

ii. përfaqëson vendndodhje me funksione fetare ose shpirtërore të njohura;

iii. përbën element identifikues të historisë ose kulturës së një grupi shoqëror; nxit ndjenjën e përkatësisë dhe vazhdimësisë kulturore në nivel komunitar.

f) Termi “Vlerë e rrallësisë” lidhet me shkallën e unikalitetit dhe përfaqësueshmërisë që paraqet pasuria e paluajtshme në raport me pasuri të tjera të ngjashme, sipas tipit, stilit, teknikës, ndërtuesit, periudhës historike apo rajonit. Kjo vlerë tregon nivelin e veçantisë së pasurisë në kontekst lokal, kombëtar apo ndërkombëtar dhe lidhet ngushtë me vlerat historike, artistike e teknike. Një shkallë e lartë rrallësie rrit rëndësinë e pasurisë dhe mund të shërbejë si bazë për vlerësim në kuadër të kriterëve të trashëgimisë botërore, kur pasuria:

i. është një nga pak shembujt e mbetur të një tipi, stili ose teknike të caktuar;

ii. përfaqëson një variant unik ose të rrallë në nivel lokal, rajonal apo kombëtar;

iii. përmban elemente që nuk përsëriten në pasuri të tjera të ngjashme;

iv. ruan nivel të lartë autenticiteti në formë, material dhe funksion;

v. ka rëndësi për dokumentimin e një periudhe, rryme ose procesi që është zhdukur ose përfaqësohet në mënyrë të kufizuar në dëshmi të tjera materiale.

3. Cilësitë që përcaktojnë gjendjen dhe qëndrueshmërinë e vlerave kulturore të pasurisë së paluajtshme janë:

a) Autenticiteti, është cilësia që tregon vërtetësinë dhe origjinalitetin e një pasurie kulturore, kur vlerat e saj historike, artistike, shkencore apo shoqërore shprehen në mënyrë të besueshme përmes formës, materialeve, funksionit, teknikave të ndërtimit, vendndodhjes dhe traditave. Ai dëshmon ruajtjen e identitetit origjinal dhe të lidhjes me kontekstin historik e kulturor të krijimit të saj. Në varësi të tipologjisë së pasurisë dhe të kontekstit të saj historiko-kulturor, një pasuri vlerësohet si autentike, nëse vlerat që mbart shprehen në mënyrë të vërtetë dhe të besueshme përmes një grupi atributash, që përfshijnë:

- i. formën dhe dizajnin;
 - ii. materialet;
 - iii. përdorimin dhe funksionin;
 - iv. traditat, teknikat dhe sistemet e menaxhimit;
 - v. vendndodhjen dhe mjedisin;
 - vi. gjuhën dhe format e tjera të trashëgimisë jomateriale;
 - vii. faktorë të tjerë të brendshëm ose të jashtëm që ndikojnë në ruajtjen e vlerave.
- b) Integriteti është gjendja në të cilën një pasuri kulturore ruan tërësinë dhe koherencën funksionale dhe kontekstuale, duke mundësuar shprehjen e plotë të vlerave që ajo mbart. Vlerësimi i kushteve të integritetit kërkon shqyrtimin e shkallës në të cilën pasuria kulturore:
- i. përfshin të gjithë elementet e nevojshme për të shprehur vlerën e saj kulturore;
 - ii. ka përmasa të mjaftueshme për të siguruar përfaqësimin e plotë të tipareve dhe proceseve që përcjellin rëndësinë e saj;
 - iii. nuk është dëmtuar nga ndikime të pafavorshme që vijnë si pasojë e zhvillimit, ndërhyrjeve jo të përshtatshme dhe/ose mungesës së kujdesit për ruajtjen e saj.
- c) Ekzistenca e një sistemi të përshtatshëm mbrojtjeje dhe menaxhimi nënkupton sigurimin e kushteve që garantojnë ruajtjen dhe forcimin e vlerave kulturore, autenticitetit dhe integritetit të pasurisë me kalimin e kohës.

Vlerësimi i ekzistencës së një sistemi të përshtatshëm mbrojtjeje dhe menaxhimi, kërkon:

- i. legjislacion dhe mbrojtje institucionale afatgjatë;
- ii. kufij të qartë dhe, nëse është e nevojshme, zonë të mbrojtur (tampon);
- iii. plan ose sistem menaxhimi që garanton ruajtjen për brezat e ardhshëm;
- iv. përfshirje të komuniteteve lokale dhe popujve autoktonë në proceset e menaxhimit;
- v. vlerësime të ndikimit mjedisor dhe të trashëgimisë për çdo zhvillim të propozuar;
- vi. përfshirje të elementeve të qëndrueshmërisë, përfshirë përballimin e ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve.

III. KUSHTET PËR KATEGORIZIMIN E VLERAVE KULTURORE TË PALUAJTSHME

1. Vlera e paluajtshme kulturore “me rëndësi universale”, kategorizohet si e tillë, nëse plotëson kushtet si më poshtë:

a) Përmbush një ose më shumë nga 6 (gjashtë) kriteret e mëposhtme, sipas Udhëzimeve Operacionale për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s:

- i. përfaqëson një kryevepër të gjeniut krijues njerëzor;
- ii. dëshmon një shkëmbim të rëndësishëm të vlerave njerëzore, në një hapësirë kohore ose brenda një zone kulturore, mbi zhvillimet në arkitekturë, teknologji, art monumental, urbanistik ose dizajn peizazhi;
- iii. ruan një dëshmi unike ose të jashtëzakonshme për një traditë kulturore ose qytetërim, ende gjallë ose të zhdukur;
- iv. është një shembull i jashtëzakonshëm i një ndërtese, kompleksi arkitektonik, teknologjik ose peizazhi që ilustron faza të rëndësishme të historisë njerëzore;
- v. është një shembull i jashtëzakonshëm i një vendbanimi tradicional, përdorimi të tokës ose të detit, që përfaqëson një kulturë ose ndërveprimin e njeriut me mjedisin, sidomos kur është bërë i cenueshëm nga ndryshimet e pakthyeshme;
- vi. është i lidhur drejtpërdrejt ose në mënyrë të prekshme me ngjarje, tradita të gjalla, ide, besime, vepra artistike ose letrare me rëndësi të jashtëzakonshme universale;

b) Kur pasuria e paluajtshme është e përzier (me vlera kulturore dhe natyrore), kategorizohet “me rëndësi universale” nëse përmbush një ose më shumë nga 4 (katër) kriteret e mëposhtme, sipas Udhëzimeve Operacionale për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s:

i. përmban fenomene natyrore madhështore ose zona me bukuri natyrore dhe rëndësi estetike të jashtëzakonshme;

ii. është shembull i shquar që përfaqëson etapa kryesore të historisë së Tokës, përfshirë regjistrin e jetës, proceset gjeologjike në zhvillim në formimin e relievit, ose tiparet gjeomorfologjike dhe fiziografike me rëndësi të madhe;

iii. është shembull i shquar që përfaqëson procese të rëndësishme në vazhdim ekologjike dhe biologjike në evolucionin dhe zhvillimin e ekosistemeve tokësore, ujërave të ëmbla, bregdetare dhe detare, si dhe të komuniteteve të bimëve dhe kafshëve;

iv. përmban habitatet natyrore më të rëndësishme dhe më domethënëse për ruajtjen *in-situ* të diversitetit biologjik, përfshirë ato që përmbajnë specie të rrezikuara me vlerë të jashtëzakonshme universale nga këndvështrimi shkencor ose i ruajtjes;

c) Garanton autenticitetin, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi;

d) Garanton kushtet e integritetit, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi;

e) Dëshmon ekzistencën e një sistemi të përshtatshëm mbrojtjeje dhe menaxhimi, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

2. Vlera e paluajtshme kulturore “me rëndësi kombëtare” kategorizohet si e tillë, nëse përmbush një ose më shumë nga termat, sipas përcaktimeve në pikën 2 dhe 3 të kreut II të këtij udhëzimi.

3. Vlera e paluajtshme kulturore “me rëndësi lokale” kategorizohet si e tillë, nëse përmbush një ose më shumë nga termat sipas përcaktimeve në pikën 2 dhe 3 të kreut II të këtij udhëzimi, me përjashtim të vlerës së përcaktuar në shkronjën f, të pikës 2, të kreut II të këtij udhëzimi.

4. Vlera e paluajtshme kulturore “me rëndësi për ansamblin” kategorizohet si e tillë, nëse plotëson kushtet në vijim:

a) mbështet karakteristikat hapësinore dhe tipologjinë arkitektonike të grup-vlerave kulturore të cilave u përket;

b) është pjesë integrale e një grupi vlerash kulturore (qendra historike, ansamble arkitektonike ose urbane, komplekse, qendra të banimit tradicional etj.);

c) kontribuon në ruajtjen e tipologjisë arkitektonike, tërësisë hapësinore dhe karakterit të përgjithshëm të ansamblit;

d) ka vlera të kufizuara individuale, por të rëndësishme për integritetin e grupit ku bën pjesë;

e) garanton autenticitetin dhe integritetin, sipas përcaktimeve të kreut II të këtij udhëzimi.

5. Vlera e paluajtshme kulturore “vetëm për referencë”, kategorizohet si e tillë, nëse plotëson kushtet në vijim:

a) ka vlera individuale të kufizuara, por që ofrojnë informacion të vlefshëm historik, kulturor, shkencor ose dokumentar për zonën ku ndodhet;

b) kontribuon në kuptimin, interpretimin ose kontekstualizimin e vlerave të tjera kulturore të lidhura me të;

c) nuk përmbush kriteret për t’u klasifikuar në kategoritë e tjera, por është e rëndësishme si burim dokumentimi, studimi ose krahasimi;

d) garanton një nivel minimal autenticiteti dhe integriteti, sipas përcaktimeve të kreut II të këtij udhëzimi.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Instituti Kombëtar Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij udhëzim.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Blendi Gonxhja